



## NJOFTIM PËR ZGJEDHJET E REJA NË DHOMËN E TREGTISË DHE INDUSTRISE DURRËS

► Në bazë të: Ligjit Nr. 9640, datë 09.11.2006, “Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 2008, datë 12.03.2015 “Për zgjedhjet në Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë dhe Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë”, si dhe Vendimit nr.1 të Komisionit Zgjedhor të datës 15.06.2023, **zgjedhjet e reja** të Asamblesë së Dhomës do të zhvillohen të **mërkurën, datë 21.06.2023, ora 09:00-17:00, pranë Zyrave të Dhomës**

► Në zgjedhje do të marrin pjesë: Shoqëritë Tregtare, Ndërmarrjet Shtetërore dhe **Personat Fizikë**, të cilët kanë derdhur kontributin vjetor për vitin 2022, si dhe ato që do të regjistrohen për herë të parë në Dhomë deri me datë **15/06/2023**.

► Votimi për Asamblenë e re (me 35 veta), do të bëhet në **4 (katër) seksione të ndara: Ndërtim, Prodhim** (industrial, bujqësor, peshkim), **Tregti** (me shumicë, me pakicë) dhe **Shërbime** (Transport, Turizëm dhe gjithë shërbimet e tjera).

► Data **19 Qershor 2023, ora 12.30** është afati i fundit i dorëzimit të formularëve të plotësuar nga ana e kandidatëve për në Asamblenë e re.

► **Mbledhja e Asamblesë së re** për zgjedhjen e Kryetarit, Kryesisë së re, dy anëtarëve të Komisionit të Auditimit dhe e përfaqësuesve të Dhomës në Bashkimin e Dhomave do të zhvillohet të **premtën, datë 23.06.2023, ora 12:00, tek Hotel “Arvi”**

**Shënim:** Të interesuarit për çdo sqarim mbi hollësi të këtij procesi zgjedhor mund të drejtohen pranë sekretarisë.

Komisioni Zgjedhor

Durrës, 15.06.2023